



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 06 korrik 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Valon Ramadani, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka, Albert Kinolli dhe Jasmina Zhivković

Munguan: Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Adem Mikullovi dhe Shqipe Pantina.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;

Miratimi i procesverbaleve është shtyrë për mbledhjen e radhës, për arsye se në komision nuk ishin disa deputetë, diskutimet e të cilëve kanë qenë të përfshira në procesverbale.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;

Komisioni shqyrtoi Projektligjin me të gjitha vërejtjet dhe propozimet dhe vendosi që Kuvendit ti rekomandojë propozim – ndryshimet si vijon:

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit, fjalët “**ligjit bazë**”, zëvendësohen me fjalët “**ligjit bazik**”.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 1, fjalët “**plotësimi dhe ndryshimi**”, ndryshohen “**ndryshimi dhe plotësimi**”.

Amendamenti 3

Neni 1, paragrafi 1, fshihen fjalët “, si dhe ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës”.

Amendamenti 4

Neni 2, nënparagrafi 1.1, fshihet fjala “**reprezantive**”, zëvendësohet me fjalën “**reprezentative**”.

Amendamenti 5

Neni 2, paragrafi 2, fshihet fjala “**pikat**”, zëvendësohet me fjalën “**nënparagraf**”.

Neni 2, nën paragrafi 1.17, fjala “**metadadada**” korrigohet si “**Metadata**”.

Amendamenti 6

Neni 5, paragrafi 1, fshihen fjalët “**dhe 2**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 7

Neni 6, 7 dhe 10, i Projektligjit fuzionohen në një nen të vetëm **6**, me radhitjen kronologjike si në vijim:

1. Nënparagrafi 2.8, i Nenit 7 të Ligjit bazik, teksti ndryshohet si në vijim:

2.8. ti paraqes për miratim, Qeverisë dhe Kuvendit raportin mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar publikohet;

Në nenin 7 të Ligjit bazik, shtohet nënparagrafi i ri, si në vijim:

2.12. ASK-ja është koordinator nacional i sistemit statistikor të Kosovës.

2. Në Nenin 7 të Ligjit bazik, paragrafi 3, shtohen dy nënparagraf të ri, si në vijim:

3.5. të krijojë borde profesionale këshillëdhënëse për fushat përkatëse statistikore.

3.6. ASK-ja ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje mirëkuptimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, sipas legjislacionin përkatës në fuqi.

Ndërsa nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 8

Neni 9, i projektligjit fshihet në tërësi.

Neni 10, fshihet, sepse është fuzionuar në nenin 6, ndërsa nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 9

Neni 18, paragrafi 2, i nenit të ri 34A, fshihen fjalët “**pikës 1 të nenit 34**” dhe zëvendësohen me fjalët “**paragrafit 1 të nenit 34A**”.

Amendamenti 10

Neni 21, paragrafi 1.3, fshihen fjalët “**këtij ligji**”, zëvendësohen me fjalët “**ligjit bazik**”.

Amendamenti 11

Neni 21, paragrafi 2.4, fshihet numri “**(3)**” dhe zëvendësohen me numrin “**(1)**”.

Amendamenti 12

Neni 22, fshihen fjalët “**gjashtë (6)**”, zëvendësohen me fjalët “**tre (3)**”.

Komisioni shqyrtoi dhe nuk i përkrahu amendamentet e Grupit Parlamentar Lista Serbe, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 3, paragrafi 1 pika 1.11 ndryshohet dhe në fund të fjalisë shtohet: “Përveç të të dhënave të cilat paraqesin të dhëna private, të cilat fare qartë shihet se nuk janë të rëndësishme për çfarëdo interesi publik qoftë”.

Arsyetim

Me shtimin e këtij teksti parandalohen keqpërdorimet eventuale, qoftë organeve qendrore, gjithashtu edhe të anketuesve në terren dhe ju mundësohet qytetarëve që të mbrojnë privatësinë e tyre nga ndërhyrjet e tepruara dhe të panevojshme.

E RËNDËSISHME

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti 2

Neni 5, i Projektligjit në versionin në gjuhën serbe kthehet në përpunim gjuhësor.

Arsyetim

Përveç kësaj që në nenin 5 ekziston një pasus i tërë në gjuhën angleze dhe një pjesë në gjuhën serbe, pika 9 nuk është në përputhje me dy versione gjuhësore tjera.

E RËNDËSISHME

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti 3

Në nenin 9 të Projektligjit, shtohet paragrafi 3 si në vijim:

Neni 0 të Ligjit Themelor i shtohet paragrafi 6 si në vijim: “Me rastin e zgjedhjes së përfaqësuesit në Këshillin e Statistikave, institucionet janë të obliguara që të kujdesen përkitazi me obligimet kushtetuese për zgjedhjen e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Arsyetim

Kushtetuta e Kosovës parasheh kuotën e detyrueshme për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, e cila vlen për të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Agjencinë e Statistikës së Kosovës. Në qoftë se Kosova dëshiron ta respektojë Kushtetutën e saj, ky obligim duhet të përshkruhet si imperativ i kohës

E RËNDËSISHME

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti 4

Në paragrafin 1 të nenit 21 të Projektligjit, në fund shtohet teksti si vijon: “Duke u përkujdesur edhe për obligimin kushtetues të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë”.

Arsyetim

Kushtetuta e Kosovës parasheh kuotën e detyrueshme për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, e cila vlen për të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Agjencinë e

Statistikës së Kosovës. Në qoftë se Kosova dëshiron ta respektoj Kushtetutën e saj, ky obligim duhet të përshkruhet si imperativ i kohës.

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament, Komisioni ka kërkuar që në procedurën e spastrimit final të tekstit të Projektligjit, pas miratimit në Kuvend, Drejtoria për Standardizim të merr parasysh raportin preliminar për harmonizimin e tekstit në tri gjuhët, sipas vërejtjeve që Drejtoria për Standardizim i ka dhënë në raportin e datës 2.3.2018, në lidhje me versionin në gjuhën angleze dhe atë serbe.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike;

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për qasje në dokumente publike dhe njëzëri votoi për miratimin në parim të Projektligjit dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, Kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Mbledhja përfundoi në orën:11:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani